

Shqipëria akuzon ish-policinë sekrete për dyndjen drejt ambasadës

Ministri i Brendshëm i Shqipërisë akuzoi të hënën ish-policinë sekrete komuniste se fshihet pas dyndjes të hënën drejt ambasadës amerikane këtu. Në këtë incident u përfshinë rrëth 1200 shqiptarë, kryesisht të rinj, të dëshpëruar për t'u larguar nga vendi më i varfër i Evropës dhe për të marrë vizë hyrjeje në SHBA.

Ministria e Brendshme bëri të ditur me anë të një deklarate se thashethemet dhe gjenjeshtrat se do të jipen viza ishte qarkulluar nga pjestarë të ish-policisë sekrete. Një 19-vjeçar u plagos në këmbë kur policia ndërhyri pranë ambasadës, por nuk pati plagosje të tjera serioze, thonë mjekët.

Grupe të rinjsh filluan të grumbullohen në Jashtë misionit të Uashingtonit në Tiranë të enjten e kaluar, pasi një fletushkë anonime e shpërndarë në Tiranë pretendonte se ofrohen vende pune¹ në Shtetet e Bashkuara.

Vocabulary

- akuz/oj, -ova, -uar** *vt* 1. accuse
2. charge, bring charges
- anonim, -e** *adj* anonymous
- brendsh/ëm (i), -me (e)** *adj* 1. inner, internal, interior 2. domestic, home
- deklarat/ë, -a; -a, -at** *nf* declaration, statement
- drejt** *prep* toward • *adv* directly, straight
- dyndj/e, -a; -e, -et** *nf* 1. migration, exodus 2. encroachment, invasion
- dëshpëruar (i, e)** *adj* desperate
- fletushk/ë, -a; -a, -at** *nf* leaflet
- fsheh, -a, -ur** *vt* hide, conceal
- gjenjesht/ër, -ra; -ra, -rat** *nf* lie
- grumbull/oj, -ova, -uar** *vt* gather, amass, accumulate • *vnon-act* gather, assemble, congregate
- hën/ë, -a (e); -a, -at (të)** *nf* Monday
- hyrj/e, -a; -e, -et** *nf* entry, entrance
- incident, -i; -e, -et** *nm* incident
- ish- prefix** former, ex-

- këtu** *adv* here
- larg/oj, -ova, -uar** *vt* remove, send away • *vnon-act* distance oneself, get away
- mjek, -u; -ë, -ët** *nm* doctor
- ndërhy/j, -ra, -rë** *vi* intervene
- ofr/oj, -ova, -uar** *vt* offer
- pasi** *conj* 1. after 2. since 3. because
4. as a consequence of, because of
- pjesëtar, -i; -ë, -ët** *nm* member
- plagosj/e, -a; -e, -et** *nf* injury, wound
- polici, -a** *nf* police, police force
- pretend/oj, -ova, -uar** *vt* claim
- pun/ë, -a; -ë, -ët** *nf* work
- qarkull/oj, -ova, -uar** *vi* circulate
- ri, -u (i); -nj, -njtë (të)** *nm* young person, youth
- sekret, -e** *adj* secret
- serioz, -e** *adj* serious, grave
- shpërndarë (i, e)** *adj* 1. scattered, dispersed 2. spread out, spread over
- thashetheme, -t** *nf* rumor, gossip

varfér (i, e) *adj* poor

viz/ë, -a; -a, -at *nf* visa

Notes

1. vend pune 'job'.

përfshij 'include'

Kryesisht 'chiefly'

më 'more; -er' (+ nyje 'most, -est')

varfér 'poor'

marr 'take'

SITBA 'USA'

di 'know'

jap 'give'

pranë 'near; at; next to; from'

them 'say' (thashë; Thënë)

jashtë 'outside'

enjte 'Thursday'